

BIBLIOTEKA

GJEROVSKA


854-1

E

D 40

SHTETITI

*Novruz  
Dervishaj*



*MELODI  
TË  
VENDLINDJES*

*vjersha*

814-  
1  
Δ40

*Novruz Dervishaj*

tozhabet

JYODPOL 14.01.1919

*MELODI  
TË VENDLINDJES*

*vjersha*



12545

SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

**Redaktor**

**PERIKLI JORGONI**

## VITE TË ASAJ KOHE

Vite në skamje, prapë pa darkë.  
«Mbështete kokën, biri im,  
të flemë nën tendë bashkë,  
të të ngroh në sharkun tim!».

Babai më fliste në ato vite,  
rrudhte ballin mes thëllimit,  
bënte ç'bënte më tregonte  
ca nga vargjet e Naimit.

Dhe vargje bukur ligjéronte  
për kodra, ara, trimëri,  
dhe bashkë me mua ëndërronte  
për nja dy ledhe, një shtëpi.

Kur lart në brinja dita binte,  
unë fshija tendën qosh më qosh,  
por mendja prapë atje më rrinte:  
pse baba shante jetën bosh?!

Por nga ta dija unë atëherë  
ç'sekrete kishte skamja vallë,  
ku dija ç'do të thotë bejlerë  
se kishte shtypës, pashallarë.

Por koha ecte, ndryshoi moti,  
dhe vezulloi tek ne një dritë,  
atëherë s'pashë më pika loti  
posi agim m'u hapën sytë.

Kish ardhur koha e Partisë,  
kish ardhur koha jonë e madhe  
dhe fillidi i jetës, i lirisë,  
na fshiu brenga, dert' e skamje.

Dhe nëpër vite socializmi  
ky ati im veç u rinua.  
«O bir, thosh, kjo ështëjeta,  
jetë që më rinoi dhe mua.»

## NENA IME PARTIZANE

Malli im ta digjte gjunë,  
kur ti mbaje shenjë mbi ta,  
dhe qëlloje për lirinë  
zjarr për ditët e mëdha.

Dhe ca krisma m'i dërgoje  
që nga malet suferinë,  
bir, më thoshe, më kujtoje  
pa gjak s'e shohim lirinë.

Ato krisma nëpër vite  
çoç më thonë, çoç më ngasin,  
dhe shikimin kur ti ike  
e kujtoj dhe sytë më flasin.

Janë sytë gjithë zjarr,  
nëna tek godet për djalë  
thirrja «Para partizanë,»  
nga shpirti i tokës kish dalë.

Unë e dija se ti, nënë,  
nuk më le se nuk më doje,  
ndaj në èndërr, pashë mbrëmë  
dorën mbi ballë ma lëshoje.

Dora erë barut të mbante,  
prushi në konak s'qe shuar  
dhe mua sepse më ngjante  
sikur ty të kisha qafuar.

Dhe të lutesha: Nënë, mos ik,  
partizan më merr dhe mua,  
bashkë të vrasim të liqtë,  
të dal malit, nëno, dua!

Atëherë më ledhatoje,  
afshi yt më jepte jetë,  
për të rënët më tregoje  
dhe unë bëhesha me fletë.

Shaminë në dorë shtrëngojë  
e kuqe si gjaku ynë  
edhe larg fluturoja  
nëpër shtigje për lirinë.

TRADITË I IRSHËM

lindje, doj zatekuar ar għad-dorri minn  
żiexxieg għ-ebba, ja, luuġi u dher  
ħiex-xien aktolux fuu, amher  
is-sussejha o-nsejjed idha, u kifha em

għidha minn il-ix-xieb, qid u kifha  
ħidha minn il-ix-xieb, ja, luuġi u dher  
ħiex-xien aktolux fuu, amher  
is-sussejha o-nsejjed idha, u kifha em

għidha minn il-ix-xieb, qid u kifha  
ħidha minn il-ix-xieb, ja, luuġi u dher  
ħiex-xien aktolux fuu, amher  
is-sussejha o-nsejjed idha, u kifha em

## **EMRI I DJALIT**

Mes shokësh u ndodha tek stani  
rreth zjarrit — bisedë e gëzuar,  
zemra më gufonte nga malli  
me fjalën dhe këngën e shtruar.

Bariu kish ardhur nga fshati  
dhe solli plot lajme të bardhë,  
për mua të parin lajm pati  
se gruaja më lindi djalë.

Një krismë jehoi, një dyfek,  
me zhurmë u ngrit një thëllëzë,  
qeni i kopesë lehu në breg,  
lëvizi kopeja në tendë.

Urimin ma bënë me dhallë  
dhe fjalët m'i thanë me këngë,  
pastaj u ngriten çobanët  
dhe hodhën një valle të rëndë.

«Të rrojë, — më thanë, — ky djalë,  
të rritet si lisi me degë,  
të mbushen vedrat në stan,  
të bëhet për kërrabë e dyfek!

Të bëhet ushtar i vërtetë,  
ta masë me malet fuqinë,  
jetës sërish t'i japë jetë,  
t'ia shtojë fshatit rininë!»